

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Nazmije Ibrahimimi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit P. C. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson me autorizim, N. Ç., avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës. (KEK), Sh.A. Prishtinë - Divizioni në Prizren, të cilën e përfaqëson me autorizim Z. Sh., nga Prishtina, për dëmshpërblim, vlera e kontestit 18.484 €, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 463/2013 datë 26.11.2015, në seancën e mbajtur më 5.4.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.463/2013, datë 26.11.2015.

Aktgjykimi i përmendur ndryshohet përkitazi me kamatën, ashtu që paditësit dëmi material duhet t'i paguhet me kamatë, sipas normës që paguajnë bankat afariste në Kosovë për depozitat e paafatizuara të kursimit, pa destinim të caktuar, mbi një vit, duke filluar nga data 15.10.2012 deri te pagesa definitive.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 463/2013, datë 26.11.2015, janë refuzuar si të pabazuara ankesat e ndër-gjyqësve dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale Prizren, C.nr. 874/2007, datë 15.10.2012, me pjesën I të dispozitivit të të cilit është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësit dhe është obliguar e paditura që paditësit t'i paguajë në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar me rastin e rënies së zjarrit në shtëpinë e tij, në shumën prej 18.484 €, me kamatë ligjore, e cila fillon të ecë nga dita e marrjes së aktgjykimit, gjer te pagesa definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita që aktgjykimi të marrë formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit të detyruar. Me pjesën II të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia përtej shumës së gjykuar, deri në shumën prej 26.179 €. Me pjesën III të dispozitivit është obliguar e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumën prej 1.785 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyruar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që dy aktgjykimet të ndryshohen, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar apo aktgjykimet e goditura të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), konstatoi:

Revizioni është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se më datë 8.11.2007 ka shpërthyer një zjarr në shtëpinë e P.C. – këtu paditësit, në Prizren, dhe me atë rast janë djegur kulmi i shtëpisë në tërësi, kurse në katin e poshtëm është djegur dyshemeja, banja, dyert e dhomave dhe janë dëmtuar nga flaka dhe tymosja mobiliet si dhe të gjitha muret e dhomave.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, ka vlerësuar se ekziston baza juridike e pagimit të dëmit të shkaktuar, baza e përgjegjësisë së shkaktimit të tij, sipas së cilës, ku kush tjetrit i shkakton dëm, ka për detyrë të kompensojë atë, nëse nuk provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, kurse përgjegjësi caktohet në bazë të fajësisë së shkaktarit të dëmit, prandaj, duke i aplikuar dispozitat e neneve 16, 154, 155 dhe 158 të LMD, ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, ka vlerësuar se përfundimi logjik dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë, sepse gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë dhe është zbatuar drejt e drejta materiale sipas përgjegjësisë së të paditurës, gjë që nuk ka mundur të vihet në dyshim me pretendimet ankimore të ndërgjyqësve dhe pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të vet.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta i kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar. Në aktgjykimet e cekura ato kanë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Thëniet e ngritura në revizion se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë me shkelje esenciale të parashikuar nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuar, ngase në aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë dhënë arsye të qarta dhe në përputhje me provat që ekzistojnë në lëndë, ndërsa në revizion, përveç që është cituar dispozita ligjore, nuk është cekur asnjë pretendim konkret se në cilën pjesën të aktgjykimit arsyet janë të paqarta dhe kontradiktore me provat mbi të cilat mbështetet aktgjykimi.

Pretendimet e parashtruara në revizion se gjykatat e instancave më të ulëta kanë zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara, ngase gjykata e shkallës së parë, në bazë të super-ekspertizës së Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Prishtinës ka vërtetuar se shkaktar i rënies së zjarrit ka qenë rryma elektrike, përkatësisht jo-normaliteti në rrjetin elektrik, që ka shkaktuar paraqitjen e zjarrit nga djegia e linjës së furnizimit, e cila përmes konzolës ka kaluar nëpër kulmin e shtëpisë, që ka qenë i ndërtuar nga një masë drusore lehtësisht e ndezshme, ndërsa masën e dëmit gjykata e ka vërtetuar në bazë të mendimit të ekspertit të ndërtimtarisë, i cili ka vlerësuar se dëmi në emër të riparimit dhe rindërtimit kap një vlerë prej 18.484 €. Gjykatat e instancave më të ulëta kanë zbatuar drejt dispozitën e nenit 154 të LMD, i cili parashikon se kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë t’ia kompensojë atë, në qoftë se nuk provon që dëmi të ketë ardhur pa fajin e tij, ndërsa në nenin 158 të po këtij Ligji është parashikuar që fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimet e cekura në revizion se e paditura nuk mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar, pasi që avaria ka ndodhur në zonën e përgjegjësisë së paditësit dhe pretendimet se në super-ekspertizë nuk janë vënë në dukje prova që do ta mbështesnin mendimin e dhënë, të cilat kanë qenë objekt shqyrtimi edhe para gjykatave të instancave më të ulëta dhe konstatoi se ato kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, mbi të cilën bazë, sipas nenit 214 par. 2 të LPK, revizioni nuk mund të paraqitet.

E paditura është obliguar që shumat e gjykuara t’i paguajë me kamatë sipas normës që paguajnë bankat afariste në Kosovë për mjetet e depozituara pa destinim të caktuar, mbi një vit, duke filluar nga data 15.10.2012 deri te pagesa definitive.

Nga sa u tha më lart dhe me zbatimin e neneve 222 dhe 224 par. 1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Rev.nr.77/2016, datë 05.04.2016

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku